



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR I SHTETIT PËR STANDARDET E SHËRBIMEVE

**Raporti gjashtëmuor për procesin e konsultimit publik, realizuar nga
Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve**

1.Përmbledhja ekzekutive

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2023, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve ka realizuar 100% procesin e konsultimit publik, duke konsultuar dhe miratuar “Dokumentin e Politikave për Standardet e Shërbimeve Publike”, i cili është objekt i ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për konsultimin e këtij dokumenti politikash janë përdorur metodat e përcaktuara ligjore si publikimi në faqen e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike nga Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, me qëllim adresimin e publikut të gjerë për marrjen e komenteve dhe sugjerimeve, njoftimi në media dhe organizimi i takimeve konsultative.

Institucionet shtetërore, komuniteti i biznesit, donatorë dhe partnerë ndërkombëtar për zhvillim, janë konsultuar gjithashtu nëpërmjet tryezave konsultative dhe komunikimit me e-mail.

Sfidë për tu adresuar mbetet rritja e reagueshmërisë dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin e konsultimit, përfshirë edhe nëpërmjet regjistrit elektronik të konsultimit publik, ku konstatohet një numër në rritje e shikueshmërisë.

2.Analiza e konsultimeve të kryera

2.1.Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

1 Vendim i Këshillit të Ministrave

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

1 akt i konsultuar, 0 akte të pakonsultuara

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Vlerësimi i ndikimit rregullator nuk aplikohet për dokumentin e politikave në përputhje me përcaktimet e pikës 45 të rregullores së Këshillit të Ministrave..

2.1.4. *Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

MSHSSH nuk ka patur akte të planifikuara në Planin Analitik Vjetor për vitin 2023 dhe PKIE. Dokumenti i politikave është parashikuar në planin e vitit 2022.

Dokumenti i Politikave për Standardet e Shërbimeve Publike i miratuar, përbën kornizën strategjike të sektorit.

2.1.5. *Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*
1 VKM

2.1.6. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*

Dokumenti i miratuar përbën aktin e parë ligjor objekt i konsultimit publik.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. *Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metodat e aplikuara ishin:

- *RENJKP, publikuar më datë 24 tetor 2022 (brenda 20 ditëve pune nga data e shpalljes së njoftimit) dhe është mbyllur me datë 21 nëntor 2022.*
- *Tryeza konsultative, më datë 9 nëntor 2022, ora 15:00-17:00; për të patur mundësinë e diskutimit të draft-dokumentit, si dhe për të marrë komente dhe sugjerime nga palët e interesuara, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, organizoi një takim/tryezë diskutimi me të gjitha palët e interesit të përfshira.*
- *E-mail, Shpërndarja e informacionit në procesin e konsultimit të hapur te palët e përfshira u bë e mundur në mënyrë elektronike.*
- *Bashkërendim ndërinstytucional me institucionet shtetërore*

2.2.2. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Tryeza konsultative gjeneroi numrin më të lartë të komenteve.

- 2.2.3. *A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit?
Nëse po, në sa raste?
N/A*

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

- 2.3.1. *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Kohëzgjatja e konsultimit online ne REKNJ ishte 20 ditë pune sipas afatit të përcaktuar nga ligji.

- 2.3.2. *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare ishte rreth 3 muaj.

- 2.3.3. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Dokumenti i miratuar përbën aktin e parë ligjor objekt i konsultimit publik. Konsultimi publik i një dokumenti politikash është një proces shumë i rëndësishëm në kuadër të hartimit të një dokumenti. Nga procesi i konsultimit publik nëpërmjet takimeve diskutimeve dhe marrjes së komenteve u arrit në përmirësimin e dokumentit deri në formën finale.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

- 2.4.1 *Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

Në fazën e hershme të draftimit të dokumentit të politikës, kanë marrë pjesë 2 ekspertë jo qeveritarë.

- 2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Ekspertë/donatorë/shoqëri civile

- 2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Dokumenti u konsultua nga rreth 30 aktorë në total: organizata ndërkombëtare dhe donatorë, shoqëri civile, ekspertë, agjenci dhe institucione publike.

- 2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Gjatë takimit të zhvilluar për konsultimin e dokumentit të politikave, u paraqitën 20 organizata/individë/ekspertë/donatorë/shoqëri civile/institucione/agjenci.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Dokumenti i miratuar përbën aktin e parë ligjor objekt i konsultimit publik.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Gjithsej 4

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Komentet e mbledhura nga procesi i konsultimit u pranuan plotësisht dhe u reflektuan në draftin final.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Dokumenti i miratuar përbën aktin e parë ligjor objekt i konsultimit publik.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

N/A

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

1/1

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeks të cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Bazuar në metodologjinë e vlerësimit të cilësisë së procesit, projektligjet janë publikuar në sistemin e informacionit qeveritar, jepen informacione të mjaftueshme për konsultime të gjera me palët e interesit; ka prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, një numëri konsiderueshëm i reagimeve të palëve të interesit është pasqyruar në projekt-akt.

Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale është 8.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Konsultimi publik i një dokumenti politikash është një proces shumë i rëndësishëm në kuadër të hartimit të një dokumenti. Sfidat më të rëndësishme lidhen me marrjen e komenteve dhe mendimeve nga qytetarët dhe bizneset nëpërmjet regjistrimit online të konsultimit publik pasi vërehet që dokumenti ka shikueshmëri por jo komente. Lidhur me organizimin e tryezave sfida kryesore lidhet me identifikimin e saktë të aktorëve që mund të jenë të interesuar, duke mos lënë mënjane dhe pa dëgjuar zërin e askujt. Në funksion të kësaj është i rëndësishëm përmirësimi i sistemit nëpërmjet marrjes së njoftimit mbi hedhjen në regjistër të një dokumenti e rrit mundësinë e arritjes së të gjitha palëve të interesuara